



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 63/1 Prot.

Tiranë, më 05.02.2020

V E N D I M

Nr.8, datë 05.02.2020

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”*, Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, institucion në varësi të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 36, datë 19.04.2019 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimi e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 437/1 prot., datë 19.04.2019, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 437/2, datë 19.04.2019 *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 437/7 prot., datë 18.12.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë 20 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 437/8 prot., datë 18.12.2019 dhe nr. 437/9 prot., datë 18.12.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projekt raporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 23402/1 prot., datë 10.01.2020, *“Kthim përgjigje”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës së bashku me observacionet, të cilat janë analizuar në përmbajtje të raportit përfundimtar.

Nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 7594/1 prot., datë 24.01.2020, *“Mbi projektraportin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionet në varësi të Ministrisë së Financave”*, ka dërguar observacionet në lidhje me konstatimet e e grupit të punës, të cilat janë pasqyruar në raportin e mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Departamenti i Administratës Publike dhe institucioni i mbikëqyrur, të përfundojnë procesin e miratimit të përshkrimeve të punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara sipas dispozitës së mësipërme të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, si dhe një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit.

3. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, për nëpunësit ***** dhe *****, për të cilët periudha e provës ka përfunduar, të plotësojë dosjen e personelit me formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, si dhe me vendimin e eprorit direkt për konfirmimin e tyre si nëpunës civilë, në përputhje me përcaktimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kryejë vlerësimin e rezultateve në punë për anëtarin e TND-së, *****, për periudhën janar – korrik 2019, në pozicionin *“Drejtore i Përgjithshëm i Thesarit”* dhe t’ia përcjellë këtë akt njësisë përgjegjëse (DAP), me qëllim që të vijojnë procedurat e parashikuara në pikën 5, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të

Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.

5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e mbikëqyrur të vendosë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për përfitimin e pensionit të pleqërisë, për nëpunësit *****; “Përgjegjës i Degës së Thesarit Krujë” dhe *****; “Specialist në Degën e Thesarit Pukë”.

Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike të marrë masa për plotësimin e pozicioneve të mësipërme, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONER

Pranvera Strakosha